Tavani munt të jetë goditur me drasa ose me "trin" (koce). Po të jetë se vatra është në mes të odës, tavani është pa drasa edhe tymi hikën përpjetë përmes tjegullave dyke u dhënë trarëve një ngjyrë të zezë fort të bukurë.

Për mi vatrën varin pastërmanë, e cila qëndron mi një lloj rjete pe trini. Jo shumë lark kësaj rjete është edhe një dru horizontal dhe mi atë thajnë robat e lagura.

Për të larë duart kanë ibrikun me koritën ose munt të vesh ke avdesanja që është më nj'anë të odës në murt. Ujet derdhet nga një vërrushkë përjashta shtëpisë.

Nevojtorja, si një kutiçkë e ngjitur në mur, është në katin e dytë, muret i ka të forta, dhe një a dy vërrushka shërbejnë për të lëftuar. Të pëgërit nuk derdhet në ndonjë kanal, po përjashta shtëpisë, dhe kjo gjë ka një pamje degutonjëse.